

**VENDIM**

Asambleja aksionereve e shoqërise SHB sha me nr. NIPTI L02424005D, e perfaqesuar nga aksioneret e saj Z.Pellumb Gjoka zoterues i 80% te aksioneve, Znj. Neta Marku zoteruese e 10% te aksioneve dhe Z.Kole Gjoka zoterues i 10% aksioneve te kapitalit te kesaj shoqërie, ne mbledhjen e saj te dates 20.12.2013, me rend dite:

1. Zgjatjen e afatit te anetareve te keshillit administrativ.

Ne mbeshtetjeje te statutit te shoqërise dhe ligjit nr. 9901 "Per Tregtaret dhe Shoqërite tregtare"

**VENDOSI**

1. Zgjatjen e afatit te anetareve te keshillit administrativ te perbere nga

Z. Pellumb Gjoka,  
Z. Indrit Ujka,  
Z. Gentjan Haka

2. Per depozitimim e ketij vendimi prane QKR caktohet z.Pellumb Gjoka

Nga data 20/12/2013 deri me 20/12/2016.

ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

Pellumb Gjoka  
Neta Marku  
Kole Gjoka



**VENDIM**

Anetaret e keshillit administrativ te shoqërise SHB sha me nr. NIPTI L02424005D, e perfaqesuar nga Z. Pellumb Gjoka, Z. Indrit Ujka, Z. Gentjan Haka, ne mbledhjen e saj te dates 20.12.2013, me rend dite:

1. Zgjatjen e afatit te administratorit te shoqërise.

Ne mbeshtetjeje te statutit te shoqërise dhe ligjit nr. 9901 "Per Tregtaret dhe Shoqërite tregtare"

**VENDOSI**

2. Zgjatjen e afatit te administratorit te shoqërise nga data 20/12/2013 deri me 20/12/2016.
3. Per depozitimim e ketij vendimi prane QKR caktohet z.Pellumb Gjoka

ANETARET E KESHILLIT ADMINISTRATIV

Pellumb Gjoka  
Indrit Ujka  
Gentjan Haka



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË

Nr.8145 REGJ.

NR. 2946 VENDIMI

**VENDIM**  
**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

**GJYQTAR: IBRAHIM HONHA**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Melvina Malaj**, sot në dt. **03.03.2014**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike kërkesën civile, që i përket:

**KËRKUES:** Shoqëria "SH.B", s.h.a, Tiranë, përfaqësuar në gjykim me autorizim nga **Sonila Boga**.

**OBJEKTI:** Miratimin e raportit te ekspertit kontabel per zmadhimin e kapitalit nepermjet kontributit ne natyre.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr.9901, neni 112, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare"

Gjykata, pasi administroi provat, dëgjoi përfaqësuesin e kërkuetit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, pasi administroi provat në tërësi;

**VEREN:**

Se kërkueti Shoqëria "SH.B" Sha i është drejtuar me një kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të së cilës kërkon: "Miratimin e raportit të ekspertit kontabel për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet kontributit në natyrë".

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes rezultoi se:

Se kërkueti Shoqëria "SH.B" Sha është e regjistruar në QKR në datë 24.12.2010 me numër nipti L02424005D dhe ka filluar aktivitetin e lojrave të fatit në muajin Dhjetor të vitit 2010. Shoqëria është e përbere nga tre aksionerë të cilët janë Pellumb Gjoka, Neta Marku dhe Kole Gjoka.

Aksioneri Kole Gjoka ka në pronësi të tijë një ambient (zyra) dhe me to kërkon të stohjë % e aksioneve duke e futur këtë ambient në asetet e kompanisë.

Për këtë qëllim nga Shoqëria "SH.B" sha është bërë dhe vlerësimi i kësaj pasurie nga ekspert kontabel i miratuar dhe është vlerësuar 28,000,000 (njëzet e tetë milion) lekë, vlerë e

marrë nga kartela e pasurisë së palujtshme Zona Kadastrale 8150, nr.pasurie 2/441-N2,volume 35 faqe 92, rruga "Luigj Gurakuqi" Tiranë. Në rubrikën "Shuma e Paguar" në kartelën e mësipërme vlera e shënuar është 200000(dyqindmijë) euro. Kjo vlerë është e konvertuar në lek me kurs 140 për euro.

Për shtimin e kapitalit në natyrë të aksionerit Kol Gjoka Asambleja e Aksionerëve ka marrë vendimin nr.01 datë 05.01.2014 dhe Nr.2 datë 12.01.2014. Në thelb të këtyre vendimeve është rritja e kapitalit në natyrë të aksionerit Kol Gjoka dhe përqindja e aksioneve për secilin aksioner të kësaj shoqërie.

Pasi ka kryer veprimet e mësipërme kërkueti Shoqëria "SH.B" Sha i kërkon gjykatës "Miratimin e raportit të ekspertit kontabel për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet kontributit në natyrë të aksionerit Z. Kol Gjoka, bërë nga ekspertja Mimoza Memoçi (Cara) datë 10.01.2014". Pasi pa këtë vendim të gjykatës nuk bëhen ndryshimet në QKR për ndryshimet e aksioneve të aksionerëve të kësaj shoqërie.

Sa mësipër gjykata bazuar në aktet shërkësore të paraqitura nga kërkueti Shoqëria "SH.B" Sha e gjen ta bazuar këtë kërkesë dhe bazuar në Ligjin Nr.9901, neni 112, datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqërite tregtare" duhet të vendos "Miratimin e raportit të ekspertit kontabel për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet kontributit në natyrë të aksionerit Z. Kol Gjoka, bërë nga ekspertja Mimoza Memoçi (Cara) datë 10.01.2014".

**PËR KËTO ARSYE.**

Gjykata bazuar në në Ligjin Nr.9901, neni 112, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqërite tregtare"

**VENDOSI:**

- Pranimin e kërkesës.
- Miratimin e raportit të ekspertit kontabel për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet kontributit në natyrë të aksionerit Z. Kol Gjoka, bërë nga ekspertja Mimoza Memoçi (Cara) datë 10.01.2014.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

U shpall sot në Tiranë datë 03.03.2014.

SEKRETARE  
MALVINA MALAJ



GJYQTAR  
IBRAHIM HONHA



Shpenzimet gjyqësore  
Takot pulle 200 lekë  
Totali 200 lekë

PULLE TARIFE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË



Vendimi mori formë të provës pasivë  
në datë 03.03.2014  
Tirane me dt. 03.03.2014

K/SEKRETARE  
MIMOZA CENAJ



ILIR KADIU